



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



---

## **E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**

**të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 03.03.2020,  
duke filluar në orën 11:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Fadil Gashi, Vala Peshku, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

**Munguan:** Egzon Azemi dhe Blerand Stavileci.

**Morën pjesë edhe:** Fatmir Bilalli, përfaqësues i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe Leutrim Retkoceri.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua ky**

### **REND I DITËS:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit dhe "AL TRADE HOLDING" LLC;**
- 3. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih Grajçevcit, Gani Azemit, Avni Azemajt, Adnan Maxhunit, Gent Azemajt dhe Alban Becit;**
- 4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Tafil (Arif) Osmanit;**
- 5. Propozimvendimi për miratimin e planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës, 2020 - 2022;**
- 6. Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme, 2020- 2022;**

7. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
8. Propozimvendimi për miratimin e ndarjes së subvencionimit për transportimin e donacionit në mallra për personat me aftësi të kufizuara;
9. Diskutim për raportin vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
10. Diskutim për raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019;
11. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

#### **Pika e dytë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit dhe "AL TRADE HOLDING" LLC.**

**Halim Halimi** tha se gjatë këtij, por edhe të vitit të kaluar, janë shpeshuar rastet e këmbimit të pronave, por për këtë duhet të jetë një rend sipas të cilit do të trajtoheshin, por këtu mua po më duket se këto po selektohen. Po ashtu, ai tha se shefave të grupeve parlamentare u ka ardhur një shkresë nga Pjetër Palushi dhe Shkëlzen Noka, të cilëve që nga viti 2014 u është ekspropriuar prona por nuk kanë marrë përgjigje nga Komuna, andaj do të ishte mirë t'u thuhet kryetarit dhe nënkryetarit që t'u kthejnë përgjigje, sepse është fjala për një sipërfaqe prej 49 arë, që gjendet afër Stacionit të trenit, pranë gjimnazit "Xhevdet Doda".

**Kryesuesi** tha se gjysma e pronës është këmbyer dhe gjysma ka mbetur. Për këtë rast kam biseduar me ish-drejtorin e Drejtorisë së Pronës, z. Dren Kukaj, se sa ka njohuri lidhur me këtë pronë, dhe kam marrë përgjigje se nuk ka lidhje tani me pronë, tani është me kadastër, pastaj e kam dërguar lëndën në Kadastër dhe jemi duke pritur përgjigje prej tyre.

**Agim Gashi** theksoi se para disa muajsh kanë pasur një takim me qytetarët e lagjes "Kalabria", të organizuar nga një organizatë joqeveritare, ku njëri nga të pranishmit ishte pronar i pronës përgjatë vijës së lumit, përroskës, ku Komuna duhet të investojë në kolektorin dhe rrugën "A", dhe ai ankohet se Komuna nuk i përgjigjet lidhur me pronën e tij.

Në raste të tilla, është mirë që Komuna me i dhënë prioritet, sepse ne kot planifikojmë buxhet për realizimin e një projekti, kur nuk e kemi zgjidhur kontestin pronësor.

**Kryesuesi** bëri të ditur se ai është takuar me atë pronar, i cili tani e ka një propozim që ia ka bërë Komuna, mirëpo atij nuk po i konvenon.

**Agim Gashi** tha në rast të kokëfortësisë së pronarit, Komuna kur e ka interesin vital, e merr vendimin në Kuvend dhe e shpall pronë me interes të përgjithshëm, pastaj procedurat shkojnë përmes procesit gjyqësor.

**Sami Boroci** u shpreh se ka herë kemi kërkuar që drejtorët të cilët kanë pika që lidhen drejtpërdrejt me drejtori të tyre, nëse nuk mund të vijnë në KPF, atëherë në seancë të Kuvendit duhet të jetë gjithsesi, kështu që është dashur me ardhur drejtorët me i sqaruar pikat e veta, në mënyrë që ne t'i kemi sa më të qarta se duhet votuar apo jo. Kam dilemë se a me votuar këtë pikë dhe ndoshta gjithë pikat që lidhen me këtë çështje, nëse nuk vije drejtori me i sqaruar.

**Genc Sherifi** u shpreh i pajtimit me parafolësin, që drejtorët me qenë të pranishëm për pikat e që kanë të bëjnë me drejtoritë e tyre. Me sa e di unë, kryesuesi i Komitetit për Pronë është Milazim Vitija, dhe është mirë që sa herë ka pika që kanë të bëjnë me pronën, me e thirrur Komitetin për Pronë dhe me kaluar këto pika përmes këtij komiteti.

**Fadil Gashi** theksoi se para 7-8 muajve kam kërkuar që të gjithë drejtorët të jenë të pranishëm në takim, por kjo nuk po përfillet.

**Jeta Rafuna** u shpreh se në seancën e kaluar kam thënë se unë jam në Komitetin për Pronë, por nuk vijnë fare këto këmbime. Drejtori i Pronës duhet kontaktuar me Komitetin, për t'i sjellë pastaj në këtë komitet këto lëndë, sepse në secilën mbledhje po sillen nga 6 - 6 këmbime, kështu që përderisa nuk vjen në Komitet dhe nuk e dimë se çka me çka po këmbejmë, unë asnjë këmbim nuk e votoj.

**Kryesuesi konstatoi se u miratuan Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit dhe "AL TRADE HOLDING" LLC, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e tretë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih Grajçevcit, Gani Azemit, Avni Azemajt, Adnan Maxhunit, Gent Azemajt dhe Alban Becit.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Tafil (Arif) Osmanit.**

**Fadil Gashi** tha se ju që po e kërkon këmbimin aty, duhet me qenë një komision ekspertësh për me ditur krejt çështjen, ju si asamblistë edhe mund të mos i kuptoni, andaj duhet drejtori me qenë i pranishëm për t'i sqaruar.

**Vala Peshku** theksoi se kam pritur që pas dy vjetëve në KPF do të fillojmë me njëfarë serioziteti në diskutime, ku thirrja jonë e vazhdueshme ka qenë që drejtorët të jenë të pranishëm në seancë, por kjo nuk po ndodh.

Po ashtu, tha se në secilën mbledhje ne po i kemi dy-tri pika që kanë të bëjnë me shkëmbim të pronave. Janë dy arsye se pse mbahet ky komitet: një, me parë pjesën se a është duke u përshtatur sipas politikave të Komunës, dhe dy, a është në linjë me vijat buxhetore. Ne e kemi për detyrë që këto çështje me ua përcjellë asamblistëve të tjerë që me ditur si të përgatiten për Kuvend.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih Grajçevcit, Gani Azemit, Avni Azemajt, Adnan Maxhunit, Gent Azemajt dhe Alban Becit, dhe Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Tafil (Arif) Osmanit, dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar në komunën e Prishtinës, 2020 - 2022 dhe**

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme, 2020 - 2022.**

**Vala Peshku** kërkoi të dijë se kush e paraqet në Kuvend Propozimvendimin për miratimin e Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar në komunën e Prishtinës, 2020 - 2022.

**Osman Bllaca** dha sqarime, duke thënë se në Kuvend pikën e pestë dhe pikën e gjashtë, do t'i paraqesë zyrtari nga Zyra për integrim.

**Agim Gashi** theksoi se do të flas në parim për pikën e pestë dhe të gjashtë, sidomos për të zhvendosurit. Së pari, si Komunë janë shërbyer me statistika të vjetra. Kur të prezantohet një plan pune dhe jepet letërnjoftimi i institucionit të Komunës, prezantohet numri i banorëve, i vendbanimeve, i territorit, i institucioneve arsimore, kulturore, të trashëgimisë etj., jepet një njoftim komplet, për të pasur një pasqyrë, për të parë se me çfarë vlerash institucionale kemi të bëjmë brenda kryeqytetit. Pra, këto mungojnë. Janë dhënë disa statistika të vjetra, p.sh. për arsim, thotë se janë 8 institucione parashkolllore, këto janë publike, por i kemi edhe 15 private, e ato nuk janë paraqitur, janë disa kolegje, nuk figurojnë as shkollat publike, as private, andaj ju lus, ofroni materiale dokumentuese të mjaftueshme, korrekte dhe reale.

Pra, unë nuk e votoj as pikën e pestë, as të gjashtë, për shkak të mungesës së statistikave dhe formulimit të tyre.

**Kryesuesi** tha se sponsorit t'i jepen vërejtjet e bëra dhe, mundësisht, deri në mbledhjen e Kuvend të përmirësohen.

**Genc Sherifi** u shpreh pjesërisht i pajtimit me zotëri Gashin për cilësinë e raportit, sepse institucionet arsimore private nuk janë kompetencë e Komunës, por e Ministrisë, Ministria i licencën çerdhet private dhe shkollat privatet. Pra, për këto nuk ka kurrfarë kompetencash Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës.

**Agim Gashi** sqaroi, duke thënë se ne nuk po flasim për kompetencat e niveleve shtetëror, por po flasim për një pasqyrë prezantimi çka ka Komuna e Prishtinës, dhe këtu e kemi një pasqyrë të mangët, ku nuk përmenden shumë institucione të rëndësishme që i ka Komuna e Prishtinës. Qëllimi im është që të kontribuoj që ky dokument të ketë fuqinë institucionale, të jetë i punuar mirë, i shkruar drejt, me standarde gjuhësore dhe me përmbajtje të mirëfillta, që prezanton informatat elementare për kryeqytetin e Kosovës.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunën e Prishtinës, 2020 - 2022, dhe Propozimvendimi për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2020 - 2022, dhe dërgohen në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

**Osman Bllaca** tha se këtu kemi të bëjmë me largimin e Hateme Gashit, përfaqësuese e DSHPMSH-së, dhe caktimin e Edona Krasniqit, zyrtare në Sektorin e Kuvendit, Drejtoria e Administratës, dhe caktohet anëtar i ri i Komitetit Lokal për Siguri Publike në lagjet "Arbëria - Tophane" nga Stacioni policor "Qendra", ku si përfaqësues i KLSP- së është caktuar Bysret Beka.

**Fatmir Bilalli** dha sqarime lidhur me këtë pikë.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e tetë**

**Propozimvendimi për miratimin e ndarjes së subvencionimit për transportimin e donacionit në mallra për personat me aftësi të kufizuara.**

**Kryesuesi** tha se për këtë pikë nuk kemi material, mirëpo lidhur me këtë do të na njoftojë z. Dren Kukaj.

**Dren Kukaj** dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim, duke cekur se në Norvegji është një qytet me emrin Arendal, ku jetojnë një numër i bashkatdhetarëve tanë, të cilët e kanë një shoqatë bamirëse, të quajtur shoqata "Fehmi Agani". Kjo shoqatë ka kontratë me Komunën e Arendollit, që deri në vitin 2025 me grumbulluar pajisje të nxjerra nga përdorimi, e që mund të përdoren ende nga personat me aftësi të kufizuara (PAK). Është hera e dytë që neve na kanë

sjellë kontingjent me pajisje. Herën e parë transportin e kanë paguar vetë, ndërsa për herën e dytë u kemi thënë se e paguajmë ne transportin, mirëpo ne e kemi të pamundshme me subvencionuar drejtpërdrejt, andaj proceduralisht si ekzekutiv duhet ta sjellim në Kuvend për votim.

Sipas Rregullores në fuqi për financimin e OJQ-ve, ne e kemi limitin që mund të financojmë në OJQ vetëm 4 mijë euro, dhe i kemi 200 mijë euro subvencion. Duhet bërë me thirrje publike, janë disa organizata që ne po dëshirojmë me i ndihmuar, që merren me shërbime dhe që duhet me i subvencionuar përmes Kuvendit, mirëpo desha me u takuar me Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe me ua sqaruar në detaje si qëndron situata me këtë subvencionim, se me thirrje publike po përfitojnë lloj-lloj organizatash dhe po shkojnë paratë vend e pa vend, e qëllimi është vetëm për ato organizata që drejtpërdrejt merren me shërbime.

**Leutrim Retkoceri** i parashtrori pyetje drejtorit, Dren Kukajt, se a ka ndonjë kalkulim për komplet koston që po dëshiron me kaluar përmes Kuvendit.

**Dren Kukaj** dha sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar.

**Agim Gashi** theksoi se është praktikë e mirë në qoftë se vlerat e mëdha, shpërndahen, kushtimisht të mëdha, pak më të mëdha se subvencionet e rëndomta, të kalojnë përmes Kuvendit, sepse edhe pse kryetari e ka njëfarë autoriteti ekzekutues deri në një vlerë të caktuar, është praktikë e mirë që mbi atë vlerë çdo ndarje e mjeteve të vijë në Kuvend, sepse shpërndahet përgjegjësia.

Sa i përket këtyre organizatave që merren me kategorinë e PAK, këtu përgjegjësi direkt kanë edhe institucionet qendrore. Nuk kam njohuri se sa jeni të koordinuar me institucionet qendrore, në mënyrë që në emër të një shpenzimi të mos financohen nga dy drejtimet, se kemi të bëjmë me një buxhet shtetëror.

**Osman Bllaca** bëri të ditur se rregullorja është ndryshuar, Rregullorja për financim të OJQ-ve, që parasheh aty vetëm 12%, do të rritet kjo përqindje.

**Kryesuesi** u shpreh se, sa i përket pjesës së parë, nga përvoja personale në Ministrinë e Diasporës, ka shumë organizata të tilla, shoqata që mund të sigurojnë falas pajisje që dalin nga përdorimi dhe janë ende të përdorshme, të mira. Unë në këtë drejtim kisha mundur me ju ndihmuar, me ju vënë në kontakt, krejt çka duan ata është me siguruar transportin dhe procedurat tjera.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e ndarjes së subvencionimit për transportimin e donacionit në mallra për personat me aftësi të kufizuara, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e nëntë**

**Diskutim për raportin vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua diskutimi për raportin vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## **Pika e dhjetë**

**Diskutim për raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua diskutimi për raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## **Pika e njëmbëdhjetë**

**Të ndryshme.**

**Leutrim Retkoceri** tha se këto pika të rendit të ditës duhet krahasuar me Planin e punës së Kuvendit, se për muajin mars është paraparë raporti vjetor për çështje ekonomike financiare, raportet vjetore për ndërmarrjet publike lokale, asnjë NPL nuk raporton për mars, bartja e buxheteve, informatë për Drejtorin e Inspeksionit, e që nuk janë në plan.

**Kryesuesi** theksoi se je një muaj përpara, kjo është mbledhja e muajit shkurt.

**Leutrim Retkoceri** u shpreh se për muajin shkurt çka është paraparë sipas planit të punës, nëse është bërë një plan qysh në fillim të vitit, dhe ky plan nuk po korrespondon me këto pika të rendit të ditës dhe mbarëvajtje të planit të punës së Kuvendit, atëherë kur paraqiten pikat, të paktën shqyrtojeni këtë plan se po i bie se është bërë pa nevojë.

**Sami Boroci** tha se raportet financiare dhe raportet e NPL-ve, ne nuk mund t'i kërkojmë në këtë fazë, ne duhet t'i kërkojmë në muajin prill ose maj raportet e NPL-ve.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:55.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta**

